



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 5

Prishtinë, më 15 prill 2010, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, TË PUNËS
DHE TË MIRËQENIES SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, Aurora Bakalli dhe Gëzim Kelmendi.

Munguan : Sasha Gjokiq dhe Nazane Breca.

Të ftuar : Kadri Bytyqi dhe Visar Ademi – nga Shoqata Farmaceutike e Kosovës, Ibrahim Xhakli nga Doganat e Kosoves, Haki Ejupi – nga Inspektorati Shëndetësor dhe Gjon Gega – farmacist.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj - administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Lejla Selimi –OSBE, Natyra Kasumaj – KDI dhe Qëndresa Ismaili- praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Diskutim lidhur me gjendjen në sektorin farmaceutik në Republikën e Kosovës,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Diskutim lidhur me gjendjen në sektorin farmaceutik në Republikën e Kosovës

Fikrim Damka - Tha se sipas propozimit nga mbledhja e kaluar, sot do të diskutojmë për ngjarjet e fundit të zhvilluara në sektorin farmaceutik të Kosovës. Sipas propozimit të ftuar janë: përfaqësuesit e Shoqatës Farmaceutike të Kosovës, Doganave të Kosovës dhe përfaqësuesit e AKPM-së. Lidhur me problematikën e parashtruar nga Shoqata Farmaceutike e Kosovës, ju japim fjalën fillimisht përfaqësuesve të kësaj shoqate.

Kadri Bytyqi – Tha se si shoqatë falënderoj anëtarët e Komisionit për interesimin e treguar për situatën e rëndë, të krijuar në sektorin farmaceutik. Greva jonë ka qenë një grevë e drejtë, por nga disa qarqe është tentuar që grevës sonë t'i jepet një konotacion tjetër, e jo ai për të cilin është bërë kjo grevë. Problemi i farmacistëve qëndron te mungesa e shumë barnave në sektorin farmaceutik, dhe pamundësia e ushtrimit me dinjitet të profesionit tonë, si dhe mos mundësia e furnizimit të pacientëve tonë me barna të nevojshme. Kjo grevë ka pasur për qëllim vetëdijesimin e institucioneve përkatëse, për gjendjen e rëndë në sektorin farmaceutik. Kërkoj përkrahjen e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për tejkalimin e kësaj gjendje.

Gjon Gega – Tha se kërkesat e shoqatës farmaceutike janë kërkesa të shtruar tani e 10 vjet. Greva jonë ka qenë një grevë e drejtë, por parashtrimi i kërkesave ka qenë i keq artikuluar dhe është krijuar një përshtypje në opinion se farmacistët janë kundër doganave, që nuk është e vërtetë. Kërkesa jonë është që pacientëve tanë t'u mundësohet qasje në barnat që atyre ju nevojiten, dhe që mos të na vdesin pacientët në mungesë të barnave. Ne kërkojmë që, barnat për të cilat furnizuesit nuk kanë ndonjë leverdi të madhe ekonomike t'i sjellin në Kosovë, të mundësohet që ato barna në mënyrë legale të hyjnë në Kosovë, dhe të mbërrijnë deri të pacientët, pra të bëhet një listë e atyre barnave dhe të gjendet një zgjidhje.

Ministria e Shëndetësisë ka dështuar që t'u sigurojë në mënyrë legale qasje në barna, qytetarëve të Kosovës. Ne nuk kemi asgjë kundër doganave, ata janë të mirëseardhur në farmacitë tona kurdo që dëshirojnë, por kërkojmë krijimin e kushteve që të punojmë në mënyrë legale.

Një vërejtje e kemi në oficerët e doganave të Kosovës, në sjelljen e tyre, ku sjellja e tyre ndaj farmacistëve nuk ka qenë në formë profesionale.

Visar Ademi – Tha se është fyese etiketimi që i është bërë farmacistëve, nga doganat e Kosovës, si kontrabandistë. Kërkesat e shoqatës farmaceutike kanë qenë të qarta, që të ndalet bastisja e farmacive. Deri te kjo situatë e rënd ka ardhur si rezultat i asaj që në AKPM janë të regjistruara vetëm 500 barna, derisa nevojat e tregut janë shumë më të mëdha. Vendet e rajonit kanë të licencuar një numër shumë më të madh të barnave, si Shqipëria 900 barna, Greqia 1300 barna etj. Ka shumë barna të cilat janë të regjistruara, por që nuk importohen në Kosovë, sepse importuesit nuk kanë leverdi ekonomike t'i sjellin, atëherë farmacistët kanë shumë pak furnizime me barna të domosdoshme. Ne, si shoqëri, duhet të angazhohemi me të gjitha kapacitetet tona që qytetarëve t'u japim qasje në barna. Në Kosovë edhe institucionet shëndetësore publike furnizohen me barna të kontrabanduara. Faji nuk mund t'u hidhet vetëm farmacistëve, faji është i gjithë shoqërisë dhe të gjithë duhet të punojmë për ta përmirësuar këtë gjendje. Doganat e Kosovës barnat i klasifikojnë si mall, që nuk duhej të ishte kështu. Barnat pa banderola duhet të trajtohen nga Inspektorati Shëndetësor, e jo nga Doganat.

Ibrahim Xhaka – Tha se Doganat veprojnë sipas Kodit Doganor dhe Akcizor të Republikës së Kosovës. Dogana e Kosoves i ka tri objektiva, e para është sistemi fiskal, pra që të krijojë të hyra, e dyta mbrojtja e shëndetit të popullsisë dhe e treta lehtësimi i tregtisë. Doganat e Kosovës sipas ligjit, edhe barnat i trajton si mall. Dogana e Kosoves në bashkëveprim edhe me administratën tatimore dhe me institucionet tjera, gjatë auditimeve që i bën në terren, has në barna pa prejardhje dhe kjo është pika ku dogana atakohet me farmacistë. Doganat presin që të bëhet një legjislacion i përshtatshëm për import të barnave, dhe kjo do të ju lehtësonte punën edhe doganave, edhe farmacistëve. Gjatë kontrolleve doganore në farmaci, ne kemi hasur në barna të prodhuesit „Galenika”, i cili prodhues fare nuk e njeh Republikën e Kosovës, dhe nuk ka aplikuar fare për licencim. Të gjitha barnatoret që nuk mund të ofrojnë dokumente për prejardhjen e barit, për licencën, zhdoganimin ose procedurat e nevojshme sipas ligjeve të Kosovës, ato barna do të konsiderohen kontrabandë dhe do të konfiskohen.

Sipas statistikave tona, të marra nga EULX- si , nga hyrjet në pikën G 1 dhe G 31, prej javës së parë deri në të katrën, buxheti i Kosovës ka humbje prej 357 mijë euro, nga barnat e pa doganuara, prej javës së pestë deri në të tetën kemi humbje 659 mijë euro, dhe prej javës 9 deri në të 12, kur janë zhvillu këto aksionet e fundit ka një rënie deri në 458 mijë euro.

Haki Ejupi – Tha se ndaj situatës së krijuar në sektorin farmaceutik duhet të kemi një qasje të drejtë, institucionale dhe multidimensionale. Si pikë kryesore kisha cekur vakumin e infrastrukturës ligjore, dhe shumë udhëzime administrative nuk kanë qenë të harmonizuara, as me ligjin, as njëra me tjetrën. Udhëzimi administrativ 08/ 2010 që ka të bëjë me çështjen e banderolës, ka shumë anomali dhe është jofunksional. Unë kam kërkuar që të krijohen depo doganore dhe mos të bëhet zhdoganimi pa u vendos banderolat, por sipas udhëzimit administrativ ka mbetur që njëherë të bëhet zhdoganimi, atëherë të vendosen banderolat dhe kjo po shkakton vështirësi. Vështirësi po shkakton edhe procedura e prokurimit, për furnizim me banderola. Në aksionin e përbashkët me doganat, i kemi pasur 18 aksione. Ne jemi munduar që me kapacitetet tona të jemi në nivelin e detyrës që na përket, dhe në asnjë rast kur kemi hasur në një bar që është i domosdoshëm për jetën e pacientit dhe që është në një ose dy paketime, nuk e kemi konfiskuar edhe pse është pa autorizim marketing. Por kemi pasur shumë raste që kemi hasur në barna me shumicë pa banderola, ose barna me banderola të shteteve të rajonit.

Flora Brovina – Tha se ishte një shqetësim në opinion për protestën dhe ishte një protestë me kërkesa jo të qarta. Ligji i ri për produkte dhe pajisje medicinale është miratuar në fund të vitit të kaluar dhe nuk ka pasur kohën e mjaftueshme të nxjerrën aktet e parapara nënligjore.

Ka shumë barna që i mungojnë listës së barnave të licencuara, por kjo listë prej 500 barnave të licencuara duhet të zgjerohet. Doganat e Kosoves i inkurajojmë që ta kryejnë punën e vet, sepse të gjithë e dimë se keqpërdorime ka dhe këto duhet të luftohen. Duhet që çështjet dhe problemet më shumë të diskutohen, dhe të gjendet një zgjidhje, sepse zgjidhja mund të gjendet. Ne kemi dëshiruar të dimë se cila është kërkesa reale e farmacistëve dhe cilat do të jen mundësit e gjetjes së zgjidhjes, pra ndoshta me akte të reja nënligjore ose me një ligj të ri.

Aurora Bakalli – Tha se interesimi ynë ka qenë që nga ju të njoftohemi më mirë për situatën. Nga ajo që është parë në media është krijuar përshtypja që barnat që janë në barnatoret e Kosovës janë me cilësi të dyshimtë, dhe kjo është një situatë shumë e rëndë. Farmacistëve ju nevojitet një betejë e re, për ta kthyer imazhin e humbur të farmacistëve.

Doganat i kisha pyetur se çfarë kanë bërë me barnat e konfiskuara? A janë dërguar këto barna në institucione publike shëndetësore? Si është bërë përzgjedhja e barnatoreve të bastisura? Përse Doganat e Kosovës i kanë ndërmarrë këto aksione pas 12 vjetëve?

Fakti që mbi 95 %, të barnatoreve kanë hyrë në grevë tregon se këta janë unik dhe se të gjitha barnatoret e Kosovës mbajnë barna pa banderola.

AKPM- në e kisha pyetur se çfarë duhet bërë që këto procedura të licencimit të barnave të shkurtohen?

Sipas informatave që kemi në sektorin farmaceutik ka edhe monopol nga disa farmacist ose furnizues, edhe kjo dukuri duhet të përmirësohet.

Salihe Mustafa – Parashtoj një pyetje për përfaqësuesin e AKPM - së përse lista e barnave të licencuara është vetëm 500 lloje të barnave, e jo më shumë. Kisha kërkuar ta kem edhe listën e barnave të licencuara dhe të kompanive që i importojnë.

Gëzim Kelmendi – Tha se duke pas parasysh gjendjen e rënd në shëndetësi, kjo situatë është si pasojë e kësaj gjendje tani e 12 vjet. Për të dalë nga kjo situatë duhet të debatohet më shumë dhe duhet të jenë prezent edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë. Kërkesat e farmacistëve duhet të jenë më të artikuluar, në mënyrë që kur të miratohet ligji i ri për produkte dhe pajisje medicinale, të përmirësohen të gjitha mangësitë e ligjit.

Cilët do të jen hapat e mëtejshëm të shoqatës së farmacistëve, për të dal nga kjo situatë?

A ka informata përfaqësuesi i AKPM -së përse është bërë vonesa e furnizimit me banderola?

Time Kadrijaj – Tha se, si Komision, kemi pritur nga farmacistët që të na drejtohen lidhur me kërkesat e tyre, por megjithatë interesimi i Komisionit ka qenë për t'u njoftuar me situatën e krijuar në sektorin farmaceutik. Mendoj se diskutimet duhet të jenë më të gjëra dhe më intensive për gjetjen e një zgjidhje. A ka adresuar shoqata farmaceutike kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë për t'u rritur lista e barnave të licencuara?

Të kemi një bashkëpunim më të mirë dhe bashkërisht të nxjerrim një ligj të mirë dhe funksional, e jo të miratojmë ligje jofunksionale dhe çdo vit t'i ndryshojmë.

Duhet të shikohet mundësia edhe e shtimit të listës së barnave të licencuara, e ta mënjanohet konflikti edhe me inspektoratin, edhe me doganat.

Bahri Thaqi –Tha se është mirë që gjërat të diskutohen, e jo të hidhet faj sa te farmacistët, sa te dogana ose diku tjetër. Edhe pyetja ime është se a ka bërë kërkesë shoqata farmaceutike në Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me zgjerimin e listës së barnave të licencuara, dhe a ka kapacitete Ministria ta zgjerojë këtë listë, a ju ka ofruar ndonjë ndihmë profesionale nga kjo shoqatë?

Nga kjo grevë e realizuar më së shumti ka qenë i dëmtuar qytetari, prandaj duhet të bëjmë përpjekje që të gjejmë një zgjidhje.

Pyetja për përfaqësuesin e doganave, informatat që i ka dogana lidhur me barnat e kontrabanduara, ku i marrin aty për aty, apo në mënyrë retroaktive më vonë?

Përfaqësuesin e inspektoratit e kisha pyetur se përse në inspektorat nuk ka farmacistë, prandaj mendoj se inspektorati duhet t'i japë përparësi në punësim farmacistëve.

Ka shumë barna që janë të licencuara, por të cilat nuk importohen në Kosovë dhe kjo po shkakton vështirësi. Në masë të madhe mendoj se ekziston mos komunikimi i duhur në mes të institucioneve përkatëse dhe kjo po e sjell edhe gjendjen në të cilën jemi.

Kadri Bytyqi – Tha se që nga fillimi ka qenë një synim që grevës t’i jepet një kahe tjetër, por ju siguroj që shoqata farmaceutike asnjëherë nuk ka pasur për qëllim që në Kosovë të mbizotërojë anarkia. Ministria e Shëndetësisë, në përjashtim të ministrit të tashëm z. Agani, asnjëherë nuk ka pasur vullnet të këtë bashkëpunim me ne. Vërejtjet tona në ligj nuk janë marrë parasysh dhe është miratuar një ligj jofunksional. Tani jemi në kontakt me ministrin Agani, që sa më shpejt të miratohet një akt nënligjor, i cili do të precizojë numrin e artikujve që mungojnë në Kosovë dhe dhënien e disa lejeve të posaçme për importin e këtyre barnave të domosdoshme. Takimet e tilla janë të rëndësishme në mënyrë që të gjenden zgjidhjet e duhura dhe qytetarët të kenë qasje në barnat të cilat ju nevojiten.

Gjon Gega – Tha se kërkesat e farmacistëve janë shumë të arsyeshme, por nga keq rtikulimi i tyre kemi ardhur deri te situata që opinioni të jetë kundër nesh. Sa i përket kërkesave tona drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, ne, në vitin 2004, i kemi dërguar letër të hapur në të cilën janë adresuar shumë kërkesa tona, por asnjëherë nuk janë plotësuar. Tani duket se ka një vullnet nga ministri Agani që kërkesat tona të marrin rrugën e zgjidhjes.

Një informatë tjetër, sa i përket citostatikëve, ju njoftoj që nuk ka asnjë bar që për farmacistët është i ndaluar të shitet, por vetëm duhet që bari të jetë i futur në rrugë legale. Farmacitë duhet të jenë të hapura vetëm nga farmacistët e jo të jenë të hapura nga biznesmenët ose nga kontrabandistët.

Ibrahim Xhaka – U informoj që barnat e konfiskuara janë dorëzuar AKPM- së, sipas udhëzimit administrativ 8/2010. Këto barna nuk do të futen menjëherë në sistemin shëndetësor, sepse ende janë në procedura të ankesave.

Përzgjedhja e barnatoreve është bërë nga njësiti i inteligjencës, ndërsa disa prej tyre kanë rrjedhur si pasojë e informimit nga barnatorja deri te depoja furnizuese. Kontrollë të tilla janë bërë edhe më herët, por jo të këtyre përmasave. Kjo ka ndodhur si pasojë e një plani të veprimit në mes të doganave dhe administratës tatimore, ku pika 4 e parasheh që vazhdimisht të ketë kontrolle sa i përket kontrabandës me barna.

Të dhënat i marrim çdo javë nga EULEKS- i, nga të hyrat në pikat doganore 1 dhe 31 dhe i krahasojmë me zhdoganimet e bëra në terminalin e Mitrovicës, pjesa jugore.

Haki Ejupi - Tha se sa i përket procedurës për marrjen e lejes së qarkullimit të një produkti medicinal nga departamenti i autorizim marketingut, procedurat me ligjin e ri janë shkurtuar nga 6 muaj, në 90 ditë, pra në 3 muaj. Ekziston edhe mundësia që një pacient në bazë të përshkrimit të mjekut, të sjellë nga ndonjë shtet tjetër terapinë e nevojshme për trajtim të atij pacienti, sipas diagnozës së përshkruar. AKPM-ja është çdo herë e hapur për regjistrimin e produkteve të reja që kanë interesim të hyjnë në Kosovë. Nuk është bërë asnjëherë harmonizimi i barnave të listës esenciale, me nevojat e pacientëve në Kosovë.

Numri i barnave të licencuara, varet edhe nga numri i kërkesave të parashtruara për licencim, sepse shumë prodhues nuk kanë edhe interes të aplikojnë për licencim në Kosovë. Tërheq edhe vëmendjen tuaj që Kosova të mos jetë treg i shpëlarjes së barnave të dedikuara për shtetet e tjera, pra të mos jem urë kaluese për shtetet e tjera.

Sa i përket vonësës së pajisjes me banderola, kjo ka ndodhur për shkak të vonësës së procedurave të tenderimit. Por tani ju siguroj se banderolat janë kontraktuar me një çmim shumë më të ultë.

Gjon Gega – Tha se banderola ka qenë një mekanizëm i korrupsionit që nuk ka kurrfarë funksioni. Inspektorat farmaceutikë, në bazë të serisë së barit, gjithmonë e dinë se kah ka hyrë bari. Kërkesë e jona esenciale është të bëhet një listë e barnave, të cilat mungojnë në tregun e Kosovës dhe ne, si farmacist, të na mundësohet qasja në këto barna.

Kadri Bytyqi – Tha se prioritet emergjent është furnizimi me barna të domosdoshme i tregut të Kosovës, dhe kisha kërkuar ndihmën e të gjithëve për tejkalimin e kësaj gjendje.

Flora Brovina – Tha se Komisioni jonë është shumë i interesuar për gjetjen e një zgjidhje dhe që do të kemi kontakte edhe me ministrin edhe me AKPM –në dhe sa më parë të gjejmë një zgjidhje.

Visar Ademi – Tha se dogana duhet ta luftojë kontrabandën te kontrabanduesit, pra te importuesit, e jo te barnatoret, sepse barnatoret nuk kanë të drejtë që të importojnë. Gjithashtu edhe kodi doganor, pjesa e dënimeve nuk përputhet te versionit i gjuhës shqipe me atë të gjuhës angleze, ku në gjuhen shqipe dënimi minimal është 5000 euro, ndërsa në gjuhen serbe dhe angleze është 500 euro. Duhet angazhuar që këto parregullsi të eliminohen.

Ibrahim Xhaka – Tha se doganat e luftojnë kontrabandën në tërë territorin e Kosovës dhe mos mundësia e funksionimit të doganave në veri është një sfidë e të gjithëve dhe kërkojmë edhe nga Kuvendi i Kosovës, që të na krijohet sa më parë mundësia e funksionimit të doganave edhe në veri. Sipas udhëzimit administrativ 8/2010, neni 8 thotë se kompetencë për konfiskimin e barnave pa banderola, pra atyre që është e domosdoshme të kenë banderola, e bën inspektorati shëndetësor në bashkëpunim me policin dhe doganat e Kosovës. Sa i përket banderolave ndoshta praktikë e mirë do të ishte të merret praktika e funksionimit të banderolave në cigare dhe në pije alkoolike.

Fikrim Damka – Tha se sipas planit të punës, shumë shpejt në Komision do ta kemi edhe plotësim ndryshimin e Ligjit për produkte medicinale dhe ne, si komision, do të punojmë që të kemi një ligj të mirë dhe që gjendja në sistemin farmaceutik të Kosovës të përmirësohet.

Pas diskutimit, Komisioni vendosi që në mbledhjet e ardhshme të ketë takim me ministrin e Shëndetësisë, dhe me kryeshefin e AKPM- së, dhe që sa më parë të gjendet një zgjidhje.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka